



KONTRATASOCIALE KUKËS

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE GUSHT 2019 - GUSHT 2020

PËRGATITUR NGA:
QENDRA PËR PROGRES RINOR

Tabela Përmbledhëse

SHKURTIME	3
FALENDERIME	4
HYRJE.....	5
METODOLOGJIA.....	7
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	8
 GJETJE NGA INFORMACIONI I MBLEDHUR NË LIDHJE ME 6 PRIORITETE E KONTRATËS SOCIALE:	 8
ANALIZA E GJETJEVE PËR SECILIN PRIORITET SIPAS KONTRATES SOCIALE:	9
 PRIORITET NR. 1:	 9
PRIORITET NR. 2:	10
PRIORITET NR. 3:	11
PRIORITET NR. 4:	11
PRIORITET NR. 5:	12
PRIORITET NR. 6:	12
 PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME	 13
REFERENCA	14
ANEKSE	15
 ANEKS 1: KËRKESË PËR INTERVISTË/DHËNIE INFORMACIONI.....	 15
ANEKS 2: PRIORITETET E KONTRATËS SOCIALE	16

Shkurtime

NE	Ndihmë Ekonomike
NJ	Njësi Administrative
URB	Zonat Urbane
RUR	Zonat Rurale
KMACP	Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë
KEMP	Asistencë për pa-aftësi për punë
Fëmijët me AK	Fëmijë me aftësi të kufizuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
PAK	Personat me aftësi të kufizuar
POP	Përballja e Ofertave Politike
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale
BTF	Bashki të Forta
COVID 19	Pandemia e Virusit Korona
Kontrata Sociale	6 prioritetet kryesore të identifikuara nga të rinjtë gjatë 2019
TDH	Terr Des Hommes

¹ Prioritetet e Kontratës Sociale <https://popnetwork.al/kontrata-sociale-me-prioritetet-kryesore-kukes/>

Falenderime

Për të hartuar këtë raport gjatë kësaj periudhe të pazakontë për shkak të pandemisë COVID-19 bashkëpunuam me shumë aktorë e institucione. Falenderojmë të rinjtë e angazhuar, Drejtorinë e Rinisë dhe të Politikave, si dhe Institucionet dhe Individët/ekspertët, për përgjigjen e shpejtë, cilësore brenda afatit kohor si dhe Këshillin Bashkiak Kukës, për vënien në dispozicion të vendimeve të marra gjatë periudhës së vecantë të pandemisë COVID-19 gjithashtu.

Falenderojmë veçanërisht të rinjtë dhe qytetarët që pranuan ti përgjigjeshin pyetjeve tona, anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) të cilët si ne po bëjnë një punë shumë të mirë pranë territoreve ku operojnë në ndihmë të komunitetit.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë **Olof Palme International Center** dhe **NED – National Endowment for Democracy** për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohet ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

Hyrje

Gjatë vitit 2019 organizatat e Rrjetit POP zbatuan projektin "Përballja e Ofertave Politike - 2019 (POP 2019)" në 9 bashki të vendit, Tiranë, Durrës, Kukës, Pukë, Vlorë, Fier, Kamëz, Pogradec, Shkodër. Përgjatë vitit 2019 u arrit që të nënshkruheshin disa Kontrata Sociale të hartuara bazuar në prioritetet e komunitetit midis kryetarëve të rinj të bashkive dhe përfaqësuesve të organizatave anëtare të POP që veprojnë në bashkitë e sipër përmendura.

Bashkia Kukës nuk e ka nënshkruar si dokument por është njohur me të.

Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike – POP", synon të rrisë debatin publik dhe përçojë informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioritetëve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP 2019, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: "Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social". Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore e Vlorës,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj "Shpresë", Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra për Progres Rinor, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Pogradec.

Gjatë vitit 2019, para dhe gjat fushatës Elektorale, ne jemi fokusuar tek sjellja së bashku e grupeve lokale të të rinjve në zonat urbane dhe rurale për të zgjedhur përparësitë e të rinjve dhe më pas prezantimit të përparësive të përzgjedhura për kandidatët në zgjedhjet vendore. Hartimi i Kontratës Sociale bëri që të rinjtë të kenë një mjet për të mbajtur kandidatët e zgjedhur për Kryetar Bashkie dhe Këshillin e Bashkisë përgjegjës për adresim e tyre.

Ndërtimi i bashkëpunimit efektiv të partneritetit me Drejtorinë e Rinisë, punonjës rinor ofrues shërbimesh rinore dhe të rinjtë, vajza e djem nga zonat e targetuar sollën formësimin e prioritetëve të Kontratës Sociale dhe konsolidimin në 6 çështje kryesore për të lobuar dhe punuar për to.

Forumet publike me të rinj kanë adresuar çështjet e shërbimeve publike; Qeverisja e mirë lokale; zhvillimi ekonomik lokal dhe dimensionin social. Kontakti i drejtpërdrejtë me të rinjtë në

shkollat e mesme nga zonat rurale dhe urbane të përfshira në proces kontribuoi me propozime konkrete si prioritete të rinjve dhe komuniteteve të tyre.

Forumi për deklarimin dhe nëshkrimin e Kontratës Sociale që ishte planifikuar gjatë fushatën zgjedhore për shkak të mungesës së alternativave dhe vendimeve politike nuk u organizua siç ishte parashikuar.

Forumi u organizua në **13 Dhjetor 2019**, me pjesëmarrjen e më shumë se 50 të rinjve, Kryetares së Këshillit të Bashkisë Kukës dhe Drejtoreshës së Drejtorisë së Rinisë.

Bashkia e Kukësit është njohur me keto prioritete zyrtarisht.

Gjatë vitit 2020 projekti vijon me *“Monitorimin e zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal.”* Gjatë kësaj faze të kësaj nisme e cila vazhdon, POP synon që të llojë dhe të advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve që janë nënshkruar në Kontratën Sociale për bashkitë: Tiranë, Kamëz, Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër, Kukës, Pukë dhe Pogradec. Gjithashtu synon përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje. Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioriteteve të kontratës sociale për periudhën Gusht 2019 – Gusht 2020.

Kjo periudhë përfshin procesin e konsolidimit të Qeverisjes vendore, njohjen me prioritetet e Kontratës Sociale, deklarimin publik të Kontratës Sociale në një takim të hapur me aktorët kryesorë vendore si dhe monitorim të mbledhjeve të Këshillit Bashkia dhe të zbatimit të prioriteteve të kontratës sociale.

Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, Qendra për Progres Rinor, për një periudhë të rëndësishme të vitit 2020, ka përshtatur aktivitetet për të ndjekur reagimin e pushtetit qendror e lokal si dhe problemet e komunitetit në përshtatje me protokollet e sigurisë.

Gjatë muajve Gusht 2019 - Gusht 2020 organizata kishte si qëllim:

- Të prezantonte prioritetet e Kontratës Sociale dhe procesin e hartimit të tyre;
- Të monitorojë Këshillin Bashkia dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Të monitorojë Këshillin Bashkia dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të llojë dhe advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve sidomos në kuadër të Dimensionit Social, Transparencës dhe Llogaridhënies.

Gjatë muajve Mars – Qershor 2020 fokus të veçantë iu kushtua menaxhimit të situatës Covid 19, vendimmarrjes së këshillit Bashkia dhe menaxhimit të pandemisë nga Bashkia Kukës².

² Raporti i publikuar rreth menaxhimit të Covid 19 <https://popnetwork.al/raporti-i-monitorimit-bashkia-kukes/>

Metodologjia

Për të realizuar raportin, Qendra për Progres Rinor, pjesë e rrjetit të POP u bazua në metodat më poshtë:

- U dërgua një letër-kërkesë me e mail për informacion aktorëve kryesorë vendorë për mundësinë e intervistimit rreth prioriteteve;
- U realizuan 11 intervista cilësore me të rinj të njësive të ndryshme, të cilët kanë qenë pjesë e aktiviteteve të mëparshme dhe kanë kontribuar në përcaktimin e prioriteteve të Kontratës Sociale;
- U monitorua në vazhdim puna e Këshillit Bashkia Kukës, Mbledhjet e keshillit on line dhe of line;
- U monitoruan vendimet e keshillit të Bashkisë Kukës publikuar në <https://www.vendime.al/vendimet-e-keshillit-bashkiak-kukes/>
- U konsultuan Rregulloret e Këshillit të Bashkisë Kukës asistuar nga programi **Bashki të Forta**;
- U intervistuan 5 ofrues të shërbimve rinore dhe njohës të fushës së zhvillit social ekonomik në Kukës;
- U monitoruan takimet e ndryshme të përfaqësuesve të bashkisë përmes TV dhe medias sociale;
- U monitoruan vendimet e Keshillit Bashkiak në lidhje me masat e vetë Bashkisë në lidhje me komunitetin në përgjithësi dhe me disa grupe shoqërore në veçanti, si dhe veprimtaria e anëtarëve të Këshillit Bashkiak.
- U analizua dhe monitorua buxheti i Bashkisë për vitit 2019 – 2020 si dhe shpenzimet respektive bazuar në open data;
- U monitorua dhe analizuan vendimet të KB që kanë lidhje me prioritetet e Kontratave Sociale bazuar në punën e rrjetit POP apo edhe nga faktorë të tjerë të jashtëm, të tipit: parashikime të mëhershme në buxhet, plane afatshkurtra apo/dhe afatgjata, puna e organizatave të tjera të cilat mund të kenë ndikuar në përmbushje (organizata qeveritare, organizata ndërkombëtare me projekte apo edhe kombëtare). Identifikimi i rolit të secilit për raste të tilla të shoqëruara me linjet përkatëse në momentin e analizave;
- Analizim i monitorimit të mediave audio vizive dhe on line në lidhje me sa më sipër sipas fushave specifike.

³Modeli i kërkesës, aneks 1

Përmbledhje Ekzekutive

Në bazë të monitorimit të Bashkisë Kukës, të kryer nga Qendra “Qendra për Progres Rinor” më poshtë disa nga gjetjet.

Gjetje nga informacioni i mbledhur në lidhje me 6 prioritete e Kontratës Sociale:

- Gjatë periudhës Gusht 2019 – Gusht 2020 është monitoruar në mënyrë të vazhdueshme Vendimmarja e Këshillit të Bashkisë;
- Këshilli është konstituar në mbledhjen e datës 2 Gusht 2019;
- Aktualisht këshilli përbëhet nga 21 Burra dhe 9 gra ose 29% gra;
- Këshilli ka miratuar Rregulloren e Përgjithshme të funksionit të Këshillit, Rregulloren e marrëdhënive të KB me Publikun dhe Media (Rreg e Konsultimeve), Rregulloren e Kërkesave, Ankesave, Peticioneve dhe Nismave Qytetare;
- Këshilli i Bashkisë i ka zhvilluar mbledhjet rregullisht duke ju përshtatur situatës së Covid 19 duke u mbledhur për vendimarrje edhe on line;
- Prioritetet e Kontratës Sociale janë relevante dhe në përputhje me nevojat e komunitetit të të rinjve dhe komunitetit në tërësi;
- Realizimi i prioriteteve është i mundshëm, i vlefshëm dhe i rëndësishëm si për qeverisjen vendore ashtu edhe për qytetarët;

Gjatë periudhës së Covid 19, Mars - Qershor 2020:

- Gjatë muajve shkurt, mars dhe prill janë 5100 familje të cilat përfitojnë ndihmë ekonomike nga Bashkia Kukës, ndjekur nga 3089 individë përfitues me statusin e aftësisë së kufizuar;
- 333 familje janë përfituese të skemës së 6% të NE mbështetur nga Bashkia Kukës;
- Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Bashkia Kukës, bazuar në donacione të njëpasnjëshme nga individë, biznese, organizata dhe fondacione, ka mundësuar ndihma për rreth 3000 familje në nevojë të identifikuar në të 15 njësitë administrative nga të cilat përbëhet. Nga kjo ndihmë deri më 30 Qershor 2020 kanë përfituar në total 3000 familje;

Komuniteti jo rezident i Romëve në Kukës me qëndrim në zonën industriale janë mbështetur me 2 pako ushqimore në kohë të ndryshme dhe janë shpërndarë bukë falas për 15 ditë me rradhë⁴.

⁴ Burimi jo zyrtar – Punonjës të angazhuar në terren

- Bashkia Kukës ka ngritur platformën on line si mundësi shtesë të komunikimit me qytetarët;
- Bashkia Kukës ka ngritur 3 grupe punë për verifikimin e familjeve pretenduese dhe në bazë të informacioneve nga terreni. 250 vizita në familje janë realizuar në familje;
- Paketat ushqimore të ndihmës gjatë pandemisë COVID-19, janë sic janë dhuruar dhe jo sipas standartit të miratuar nga Qeveria; Përmbatja e paketës ka qenë në varësi të donatorit dhe shpërndarja e tyre bëhet bazuar në sasi dhe në numrin e anëtarëve të familjes;
- Nuk ka ndarje gjinore për shumë nga të dhënat që morëm. Kjo na pengon të analizojmë gjetjet nga pikpamja gjinore;

Bashkia Kukës nga buxheti i saj që nga fillimi i Emergjences deri me datë **30 Gusht 2020** ka shpenzuar **3,851,033 ALL për desinfektant dhe pako ushqimore. 420,000 ALL** janë paguar për një tunel disinfectimi pjesërisht funksional.

- Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Shtetërore ka **kontribut minimal** gjithë kësaj periudhe.
- Drejtoria e Shërbimeve Sociale Bashkiake nuk disponon statistika gjinore për të rinjtë e të rejtat. Pasi në zbatim të vendimit nr. 236, datë 19.03.2020, të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, të rinjtë nuk janë ndër kategoritë e klasifikuara si shtresa në nevojë;

Analiza e gjetjeve për secilin Prioritet sipas Kontratës Sociale:

PRIORITET NR. 1:

Përshtatje e ambjenteve ekzistuese, pronë e Bashkisë për Qendër Rinore multifunkionale brenda vitit 2020; Manaxhim i saj nga vetë Bashkia ose të jepet në përdorim ambjenti tek Organizata që janë në gjendje ta menaxhojnë dhe ofrojnë si shërbim;

Gjatë kësaj periudhe përveç QPR Kukës ka edhe aktorë të tjerë të cilën janë përpjekur të ofrojnë shërbime për të rinjtë pa një qendër të mirfilltë rinore. QPR vazhdon ofrimin e

⁵ Burimi jo zyrtar – punonjës të angazhaur në proces

⁶ http://spending.data.al/en/treasury/list/year/2019/dege_id/17/inst_code/2125001 vizituar ne datë 23 Shtator 2020

⁷ Z. Safet Gjici, Kryetar i Bashkisë Kukës, Intervistë me TVSH 27 Prill 2020

shërbimeve me karakter rinor, edukim jo formal, trajnim, shkëmbim eksperincash në nivle kombëtar e ndërkombëtar.

American Corner është një tjetër hapsirë me shumë vlerë në Kukës. Me hapsirën cilësore, fondin e mjeteve dhe librave në gjuhë të huaj në dispozicion, në përtneritet edhe me QPR Kukës, America Corner Tiranë dhe Vlore, me mbështetjen e Ambasadës Amerikane kanë organizuar aktivitete të ndryshme për të rinjtë.

Terre des hommes me programin e saj IRMA ka targetuar kryesisht të rinj të rikthyer nga emigracioni dhe të rinj nga familje në nevojë. Shërbimet e ofruara janë orientuar drejt këshillimit të karrieres, këshillim psikologjik e social, mbështetje për iniciativa rinore dhe aftësim për jetën.

Këto shërbime të ofruara nga partner të rëndësishëm dhe të ndryshëm do të koordinoheshin mjaft mirë nëse do të kishte një hapsirë të mirfilltë rinore me funksion të dedikuar si Qendër Rinore.

PRIORITET NR. 2:

Ndërhyrje në sistemin sanitar në Shkollat: Bicaj, Shishtavec, Gostil, Kolsh dhe Topojan për vitin 2020. Vlerësim të gjendjes në të gjitha Shkollat.

Gjatë vitit 2019 – 2020 janë identifikuar dy ndërhyrje në sistemin sanitar: në Shkollën 9 vjecare Bicaj në Bashkëpunim me Peace Corp dhe Bashkinë Kukës si dhe në Shkollën e mesme të Bashkuar Shishtavec me mbështetjen e Ambasadës Bullgare në Shqipëri janë realizuar ndërhyrje të nyjeve sanitare.

Gjatë kësaj periudhe janë identifikur 3 përfundime të ndërtimeve – rikonstruksion të Shkollave Shtiqën, Mamëz dhe Fshat si dhe këndit Sportiv në Shkollën Shtiqën. Të gjitha këto ndërhyrje janë vazhdimi e mandatit të mëparshëm.

Shërbimet publike kanë vijuar mirmbajtjen rutinë më ljerje, ndërhyrje të vogla dhe emergjente. Situata e Civid 19, protokollet dhe nevoja për kushte higjienike të shtuara ka nxjerr në pah emergjencën në të cilën sistemet sanitare ndodhen, mungesën e furnizimit me ujë dhe pamundësinë e funksionimit në kushte të pranueshme. Disa shkolla kanë dëmtime strukturore dhe shumë të tjera mungesë të furnizimit me ujë⁸.

⁸ <https://www.rtsh.al/lajme/kukes-shtate-shkolla-rrezikojne-hapjen/>
https://a2news-com.cdn.ampproject.org/v/s/a2news.com/2020/08/28/hapja-e-shkollave-ne-kukes-problem-jane-fondet-dhe-uj-i-pijshem/amp/?amp_js_v=a6&_gsa=1&usqp=mq331AQFKAGwASA%3D#aoh=16012896068684&referrer=https%3A%2F%2Fwww.google.com&_tf=From%20%251%24s&share=https%3A%2F%2Fa2news.com%2F2020%2F08%2F28%2Fhapja-e-shkollave-ne-kukes-problem-jane-fondet-dhe-uj-i-pijshem%2F

PRIORITET NR. 3:

Përcaktim në buxhet të zërit të dedikuar për financim me 20% të programeve Start Up me partnerët aktual GIZ – IDEA, UNDP dhe Partners Shqipëri apo organizatave të tjera të angazhuara në këtë fushë. Përcaktimi i një fondi prej 700,000 ALL për vitin 2020.

Ky prioritet nuk është realizuar. Në bashkpunim me Këshillin e Bashkisë dhe BtF do të iniciohet një proces lobimi dhe mbështetje për qartësim të modaliteteve dhe përfshirjen e këtij financimi në buxhetin e vitit 2021. Rregulloret e keshillit krijojnë kushtet e përshtatshme dhe sigurojnë mbështetjen praktike për lobim.

PRIORITET NR. 4:

Ndikim në këshillim të karrierës në të gjitha shkollat e mesme brenda territorit të bashkisë Kukës dhe organizim të dy Panairëve të Mundësive nga vetë Bashkia ose kontraktim nga ofrues më eksperimente. Përcaktim të kuotës prej 30 të rinj për ofrim të trajnimit profesional në Kukës, Prizren apo Tiranë dhe financim i kostove të transportit.

Si pjesë e procesit u analizua situata e Këshillimit të karrierës në Shkollat:

Këshillim i nxënësve për përzgjedhjen e lëndëve me qëllim orientimin e nxënësve për studimet e larta, kjo bazuar në tre parime:

1. Meritë, 2. Preference, 3. Tregu i punës, kjo e fundit jo mbi bazën e ndonjë të dhëne statistikore konkrete, por mbi bazën e të dhënave që vijnë në rrugë të ndryshme.

Si koncept këshillimi i karrierës është e qartë në masën 85%, pasi nxënësit janë në dijeni të kornizës kurrikulare dhe të tërësisë së programit/planit mësimor në gjimnaz. Nxënësit janë në dijeni të ndryshimeve kurrikulare në funksion të qëllimit studimor në shkollat të larta.

Këshillimi në karrierë është shumë ndihmuese, pasi përzgjedhja është përcaktuese për drejtimin studimor në studimet e larta, kjo në përputhje me interesin e nxënësit, në përputhje të mundësive, meritës dhe të tregut të punës.

Mënyra më e mirë për të patur një orientim cilësor të karrierës nga të rinjtë do të ishte takime sa më të shumta me grupe të vogla të nxënësve të klasave të XI, pasi përzgjedhja e lëndëve që orientojnë ata drejt studimeve të larta, profesionit dhe tregut të punës.

a2news.com%2F2020%2F08%2F28%2Fhapja-e-shkollave-ne-kukes-problem-jane-fondet-dhe-uj-i-pijshem%2F

⁹Intervistë me Dr. F Ollomani, Zyra e Arsimit Kukës

Gjatë kësaj periudhe me mbështetjen e GIZ dhe Ambasadës Britanike TdH po ofron në këshillim karriere për të rinjtë një Kukës. Gjithashtu, me mbështetjen e GIZ, QPR ka zbatuar projektin në mbështetje të zhvillimit të ideve dhe iniciativave të sipërmarrjes nga të rinj, kryesisht të rikthyer nga emigracioni dhe të papunë.

PRIORITET NR. 5:

Punësim sezonal prej 2 muajsh pranë Institucionit të Bashkisë Kukës dhe Drejtorive në varësi të 20 të rinjve student të viteve të fundit Bachelor dhe Master në profilet e tyre të studimit.

Me iniciative dhe në mbështetje të kërkesës së Drejtorisë së Rinisë, Bashkia Kukës kishte planifikuar zbatimin e prioritetit të mësipër. Për shkak të pandemisë nuk ishte e mundur zbatimi i tij. Në bashkpunim me Drejtorinë e Rinisë do të lobohet që për vitin tjetër në bazë edhe të kushteve dhe situatës të zbatohet si prioritet.

PRIORITET NR. 6:

Përcaktimi i një fondi specifik në Buxhetin e vitit 2020 - 2021 prej 1,600,000 ALL për mbështetje të aktiviteteve rinore; Përcaktim i modaliteteve të konkurimit dhe gjithpërfshirje të grupeve rinore në të gjitha njësitë administrative.

Prioriteti i mësipërm mbetet sfidë. Bashkia e Kukësit ka si pjesë përbërëse dhe të rëndësishme të saj Drejtorinë e Rinisë dhe Projekteve. Duke qenë se statusi i saj ka qenë i paqartë dhe here here i mbivendosur, e pa mbështetur me fonde të vecanta për planifikim të aktiviteteve të saj në shërbim të të rinjve, ka bërë që të vërehet vështirësi në angazhimin e saj me kapacitet të plotë. Gjatë kësaj periudhe, në takime periodike dhe në konsultat e zhvilluara, Drejtoria e Rinisë është mbështetur që të hartojë planin e saj të punës dhe të paraqesë kërkesa buxhetore të veçanta bazuar në planin e punës dhe të aktiviteteve. Sigurimi i një fondi të tillë mbështetës do rriste pavarësinë e Drejtorisë së Rinisë, do të krijonte mundësi për aktivitete të shtuara Rinor dhe do të nxishte të rinjtë si të zonave rurale ashtu edhe urbane për angazhim komunitar.

Rregulloret e Këshillit dhe kryesisht rregullorja e Kërkesave, Ankesave, Nismave Qytetare dhe Peticioneve siguron mjetet dhe modalitete për lobim të kësaj nisme.

¹⁰ <https://kukesi.gov.al/programi-kombetare-i-praktikave-te-punes/>

Përfundim dhe Rekomandime

- ✓ Prioritete e Kontratës Sociale janë relevante, të arsyeshme dhe pjesë e prioriteteve të fushë së rinisë;
- ✓ Prioritetet janë zbatuar pjesërisht dhe mbetet shumë punë për të bërë deri në realizimin e tyre;
- ✓ Partneritet me Këshillin e Bashkisë dhe Drejtorinë e Rinisë, në zbatim edhe të Rregulloreve të reja të keshillit të miratuara gjatë vitit 2019 – 2020 sigurojnë mbështetje për lobim për realizim të prioriteteve;
- ✓ Këshillimi karrierës mbetet një prioritet me shumë interes për të rinjtë, dhe duhet rishikuar mundësia e krijimit të një moduli nga ekspertë në bashkëpunim me Drejtorinë e Rinisë që të zbatohet periodikisht.
- ✓ Grupet e vogla rinore aktive, pavarësisht se janë të fragmentizuara, janë të interesuara për ndryshim social, por shpesh herë nuk merren parasysh dhe nuk dëgjohen.
- ✓ Të nxitet mekanizmi i iniciativave qytetare, si mundësi pjesëmarrjen e grupeve rinore për çështjet e lidhura drejtperdrejt me grupin e tyre shoqëror.
- ✓ Drejtoria e Rinisë mund të organizojë fushata për ngritje fondesh, nëse nuk arrihet të krijohet një fond specifik për mbështetjen e aktiviteteve rinore nga buxheti bashkiak në bashkëpunim me partnerë lokal dhe kombëtar.
- ✓ Kushtet sanitare në shkolla mund të përmirësohen vetëm me përcaktimin si prioritet kryesor nga Bashkia, pavarësisht mundësive për bashkëpunim me keshillat e prindërve, ndërhyrje nga mbështetës dhe donatorë apo partnerë të mundshëm.
- ✓ Menaxhimi i përqëndruar i mbështetjes së familjeve në nevojë me pako ushqimore gjatë pandemisë është efektiv dhe pozitiv.

Referenca

Ligji 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”

Rregulloret e Funksionimi të Këshillit të Bashkisë

Kontrata Sociale, prioritetet

<https://kukesi.gov.al/keshilli-bashkiak/>

<https://portavendore.al/2020/08/13/deputetet-bullgare-dhurojne-fonde-per-shkollen-e-mesme-ne-shishtavec/>

<https://www.vendime.al/vendimet-e-keshillit-bashkiak-kukes/>

<https://popnetwork.al/category/aktivitete-kukes/>

<http://spending.data.al/en/treasury/list/year/2019/>

Aneksë

Aneks 1: Kërkesë për Intervistë/dhënie informacioni

Datë __/08/2020

Nga: “Qendra për Progres Rinor” Kukës

Për: _____ Bashkia Kukës

MONITORIMI I PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE TË KONTRATAVE SOCIALE POP 2019

Pas përfundimit të fazës së parë të Projektit “Përballja e Ofertave Politike” mbështetur nga Olof Palme International Center dhe SIDA Suedi, zbatuar në 9 Bashki në Shqipëri, dhe përfundimit të organizimit të forumeve publike të Kontratave Sociale, përcaktim të prioriteve, bërja publike e tyre me 13 Dhjetor 2019, në partnerit me Bashkinë Kukës, sektorët përgjegjes të saj si dhe Këshillin Bashkiak, faza vijuese kërkon **monitorimin** e përmbushjes së prioriteve të komunitetit të të rinjve.

Prioritete bashkangjitur janë të përgjdhura nga vetë të rinjtë e komuniteteve të targetuara.

Bazuar në prioritetet bashkangjitur, kërkojmë nga ana juaj informacion rreth tyre si dhe zhvillimeve të fundit që insitucioni ju ka ndërmarrë për ti adresuar ato.

Metodologjia bazohet mbledhje dhe analizë të informacionit zyrtar si dhe nga burime të tjera.

Intervista/bashkbisedimi do të jetë gjysëm i strukturura duke anuar në lirshmërinë e diskutimit si për këto prioritete ashtu edhe plane apo prioritete që vetë Bashkia Kukës i konsideron si shumë të rëndësishme në mbështetje të të rinjve në Kukës.

Gjetjet dhe deklaratimet do të përfshihen në Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Kontratës Sociale ku do të përfshihen edhe rekomandime dhe propozime për partneritete të mundshme i cili do t'ju vihet në dispozicion edhe ju. Bashkangjitur do të gjeni 6 prioritetet e kontratës Sociale.

Faleminderit për kohën

Aneks 2: Prioritetet e kontratës Sociale

PRIORITET NR. 1:

Përshtatje e ambjenteve ekzistuese, pronë e Bashkisë për Qendër Rinore multifunktionale brenda vitit 2020; Manaxhim i saj nga vetë Bashkia ose të jepet në përdorim ambjenti tek Organizata që janë në gjendje ta menaxhojnë dhe ofrojnë si shërbim

PRIORITET NR. 2:

Ndërhyrje në sistemin sanitar në Shkollat: Bica, Shishtavec, Gostil, Kolsh dhe Topojan për vitin 2020. Vlerësim të gjendjes në të gjitha Shkollat.

PRIORITET NR. 3:

Përcaktim në buxhet të zërit të dedikuar për financim me 20% të programeve Start Up me partnerët aktual GIZ – IDEA, UNDP dhe Partners Shqipëri apo organizatave të tjera të angazhuara në këtë fushë. Përcaktimi i një fondi prej 700,000 ALL për vitin 2020.

PRIORITET NR. 4:

Ndikim në këshillim të karrierës në të gjitha shkollat e mesme brenda territorit të bashkisë Kukës dhe organizim të dy Panairëve të Mundësive nga vetë Bashkia ose kontraktim nga ofrues më eksperiment. Përcaktim të kuotës prej 30 të rinj për ofrim të trajnimit profesional në Kukës, Prizren apo Tiranë dhe financim i kostove të transportit.

PRIORITET NR. 5:

Punësim sezonal prej 2 muajsh pranë Institucionit të Bashkisë Kukës dhe Drejtorive në varësi të 20 të rinjve student të viteve të fundit Bachelor dhe Master në profilet e tyre të studimit.

PRIORITET NR. 6:

Përcaktimi i një fondi specifik në Buxhetin e vitit 2020 - 2021 prej 1,600,000 ALL për mbështetje të aktiviteteve rinore; Përcaktim i modaliteteve të konkurimit dhe gjithpërfshirje të grupeve rinore në të gjitha njësitë administrative.